



RAPORT I AVOKATIT TË POPULLIT

mbi hetimin në lidhje me Kërkesën për Rishikim të Vendimin të Avokatit të Popullit lidhur me Ankesën e Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit, Haxhi Shalës dhe Isni Kilajt kundër Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Kërkesë që Avokati i Popullit të ushtrojë kompetencën e tij sipas nenit 49(5) të Ligjit nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") për t'i referuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese aspektin e kushtetutshmërisë të Rregullores KSC-BD-25/Rev1

Nr. OMB-C-2024-02
Lëshuar më 21 maj 2024

PUBLIK

Më 21 maj 2024, Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës ('Avokati i Popullit'),

Pasi mori në shqyrtim kërkesën e lartpërmendur për rishikim të Vendimit të Avokatit të Popullit, merr këtë vendim:

I. PROCEDURA PARA AVOKATIT TË POPULLIT

1. Kërkesa për rishikim u regjistrua në Zyrën e Avokatit të Popullit më 9 maj 2024;

II. FAKTET

2. Faktet e lëndës që çuan në ankesën e parë dhe vendimin e parë të Avokatit të Popullit janë paraqitur në Raportin e parë.¹

¹ Shih Raportin e Avokatit të Popullit OMB-C-2024-02, Pjesa II, dhe KSC-CC-2024-23, Kërkesa Referuese e (1) Sabit Januzit, (2) Ismet Bahtijarit dhe (3) Haxhi Shalës drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Kushtetutshmërinë e KSC-BD-25/Rev1, 2 prill 2024.





III. KËRKESA PËR RISHIKIM

3. Në emër të katër parashtruesve, mbrojtësit parashtruan një kërkesë për rishikim të vlerësimit të parë të Avokati i Popullit për lëndën OMB-C-2024-02, të datës 8 maj 2024.
4. Në emër të kërkesës për rishikim të parashtruesve, mbrojtësit parashtruan si në vijim:
 - a) se, në vlerësimin se ai nuk mund të shqyrtonte asnjë kërkesë referuese drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (DHSGJK), për shkak se afati për paraqitje të kërkesave referuese kishte përfunduar, të cilit ai duhet t'i përmbahet sipas rregullës 26(1) të Rregullores së Procedurës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (RRPDHSGJK), Avokati i Popullit kishte gabuar që nuk mori parasysh rregullën 6(4), "e cila bën të qartë se cilido afat mund të zgjatet dhe çfarëdo veprimi që ndërmerret pas përfundimit të afatit mund të gjykohet i vlefshëm". Ata parashtruan se ky është një gabim i konsiderueshëm dhe rrjedhimisht e bën vlerësimin të gabuar. Mbrojtësit argumentojnë se "Gjithashtu, ka arsye krejtësisht të vlefshme për të zgjatur afatin që Avokati i Popullit t'ia referojë DHSGJK-së kërkesën në lidhje me KSC-BD-25/Rev1, në mënyrë që, në këtë fazë, t'i lejohet të referojë ligjin e kontestuar dhe/ose që kërkesa referuese e Avokatit të Popullit të konsiderohet e përligjur në këtë fazë. Në rrethanat aktuale, Avokati i Popullit ishte në dijeni shumë para 25 prillit 2024 për shqetësimet e parashtruesve në lidhje me Rregulloren për Ndihmë Juridike të Rishikuar."
 - b) se "më 7 mars 2024, vetëm 14 ditë pasi Administratorja njoftoi se ndryshimet, të cilat u bënë pa konsultime ose njoftim, do të hynin në fuqi menjëherë, Avokati i Popullit u takua personalisht me parashtruesit e ankesës në objektin e paraburgimit, të cilët shprehën shqetësimet e tyre se rregullorja e rishikuar ishte e papajtueshme me Kushtetutën dhe të drejtën për gjykim të drejtë. Megjithatë, Avokati i Popullit nuk ndërmori asnjë veprim në atë fazë."
 - c) se, Avokati i Popullit, në përputhje me rregullën 29(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara (RRPP), pati të drejtë të paraqitej dhe t'i bashkohej Kërkesës Referuese të mbrojtësve në emër të Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit, Haxhi Shalës dhe Isni Kilajt dhe ishte në pozitë ta bënte atë plotësisht brenda afatit 2-mujor i cili vlen për Avokatin e Popullit sipas rregullës 26(1) të RRPDHSGJK.²
 - d) se "fakti që Avokati i Popullit nuk ndërmori asnjë hap për të ushtruar të drejtën e tij të paraqitjes para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me referim

² Shih KSC-CC-2024-23 Kërkesa Referuese e (1) Sabit Januzit, (2) Ismet Bahtijarit dhe (3) Haxhi Shalës drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Kushtetutshmërinë e KSC-BD-25/Rev1, 2 prill 2024.



për këtë ligj të kontestuar brenda dy muajsh që kur befas u bë i ditur, pa periudhë për konsultim dhe pa njoftim për hyrje në fuqi të të njëjtës rregullore, dhe pa analizë gjyqësore ose administrative para dhe pas tij nga ndonjë organ i pavarur, nuk përbën bazë që Avokati i Popullit të hedhë poshtë kërkesën që Avokati i Popullit të ushtronte kompetencën e tij që ligjin e kontestuar ta referonte për të vlerësuar nëse është i pajtueshëm ose jo me Kushtetutën, edhe në qoftë Avokatit të Popullit në këtë fazë i duhet të kërkojë zgjatje të afatit sipas rregullës 6(4) të RRPDHSGJK-së.”

- e) se “roli i Avokatit të Popullit është që të veprojë në mënyrë të pavarur për të monitoruar, mbrojtur dhe ruajtur të drejtat dhe liritë themelore të personave nga veprime ose mosveprime të paligjshme ose të palejueshme nga autoritetet publike siç janë Dhomat e Specializuara dhe organet e saj, përfshirë Zyrën Administrative (ku Avokati i Popullit, në mënyrë kundërthënëse, është pjesë përbërëse) (shih nenin 132(1) të Kushtetutës, neni 34(9) i Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar nr.05/L-053, dhe rregullën 28(2) të RRPP-së). Ky rol përfshin referimin Gjykatës Kushtetuese të pyetjeve të vlefshme në lidhje me kushtetutshmërinë e rregulloreve të krijuara nga Administratorja, duke përdorur dispozitën e rregullës 6(4) të RRPDHSGJK-së që mundëson kërkesën për zgjatje të afatit nëse është e nevojshme”.
- f) “Në këto rrethana, mbrojtësit kërkuan që Avokati i Popullit të rishikojë vlerësimin e vet për t’i referuar DHSGJK-së aspektin e kushtetutshmërisë së KSC-BD-25/Rev1, veçanërisht duke pasur parasysh rregullën 6(4) të RRPDHSGJK-së dhe dispozitën që Avokati i Popullit të kërkojë zgjatjen e afatit për t’ia referuar aspektin DHSGJK-së”.

IV. VLERËSIMI I AVOKATIT TË POPULLIT

I. Pavarësia e Avokatit të Popullit

5. Fillimisht, Avokati i Popullit dëshiron të trajtojë aspektin e pavarësisë së tij, të cilën mbrojtësin e ngritën duke iu referuar në mënyrë të vagullt pozitës së zyrës së tij në Zyrën Administrative. Rregulla 28 (1) e RRPP-së përcakton se Zyra Administrative përfshin **zyrën e pavarur** të Avokatit të Popullit të Dhomave të Specializuara.
6. Rregulla 28(2) thotë se Avokati i Popullit vepron në mënyrë të pavarur për të monitoruar, mbrojtur dhe ruajtur të drejtat dhe liritë themelore të personave që ndërveprojnë me Dhomat e Specializuara (DHS) dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS) në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren.
7. Pas emërimit të tij, Avokati i Popullit bëri betimin solemn përpara Administratores në përputhje me rregullën 28(4) të RRPP-së.
8. Neni 162 (11) i Kushtetutës së Kosovës përcakton se do të emërohet një **Avokat i Popullit** i veçantë i Dhomave të Specializuara me përgjegjësi ekskluzive për DHS-në



dhe ZPS-në, funksioni dhe obligimet e tij/saj për raportim do të përcaktohen me ligjin e veçantë.

9. Në përputhje me nenin 162(1) të Kushtetutës, organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar rregullohen me nenin 162 dhe me ligj të veçantë.
10. Ligji në fjalë është Ligji për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar³, dispozita përkatëse është neni 34(9) i cili thotë:

(9) Zyra Administrative përmban brenda vetes Zyrën e Avokatit të Popullit, e cila e kryen detyrën e Avokatit të Popullit të Dhomave të Specializuara me përgjegjësi ekskluzive për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar sipas Amendamentit nr. 24 të Kushtetutës. Ligji për Avokatin e Popullit, Ligji nr. 03/L-195, nuk zbatohet për punën e Dhomave të Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Avokati i Popullit do të emërohet nga Autoriteti Emërues pas shqyrtimit të aplikantëve të kualifikuar⁴. Avokati i Popullit ka karakter të lartë moral dhe është kompetent në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut. Roli dhe funksioni i Avokatit të Popullit të Dhomave të Specializuara rregullohet në Rregullat e procedurës dhe provave. Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara mund t'i jap rekomandime Kryetarit të Dhomave të Specializuara ose Zyrës së Prokurorit të Specializuar sipas nenit 135(3) të Kushtetutës dhe mund të bëjë referime për tek Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113(2) dhe 135(4) të Kushtetutës dhe nenin 49 të këtij ligji.

11. Amendamenti kushtetues dhe Ligji nr.05/L-053 u miratuan nga Kuvendi i Kosovës.
12. Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës u miratua nga Plenarja më 17 mars 2017. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese vendosi njëzëri që rregullat 28 dh 29 janë ndër dispozitat që nuk janë mospërputhëse me Kapitullin II të Kushtetutës⁵.
13. Avokati i Popullit është më se i vetëdijshëm për rolin dhe funksionet e tij dhe i kryen në mënyrë krejt të pavarur nga Dhomat e Specializuar dhe organet e saj, përfshirë nga Zyra Administrative dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar.

II. Kërkesa që Avokati i Popullit të rishikojë vlerësimin e vet të kërkesës së parë për t'i referuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (DHSGJK) aspektin e

³ Ligji nr. 05/L-053

⁴ Emëruar nga Shefi i Misionit të EULEX-it në Kosovë si Zyrëtar Emërues sipas nenit 1(2) dhe nenit 34(9) të Ligjit nr. 05/L-053.

⁵ Aktvendim në lidhje me referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017 2017 drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 mbi Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, KSC-CC-PR-2017-01/F00004, 26 prill 2017.



kushtetutshmërisë së KSC-BD-25/Rev1, konkretisht duke pasur parasysh rregullën 6(4) të Rregullores së Procedurës para Dhomave të Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (RPDHSGJK) dhe dispozitën që Avokati i Popullit të kërkojë zgjatjen e afatit për t'ia referuar aspektin DHSGJK-së.

14. Neni 113(2) i Kushtetutës, sikurse pasqyrohet në nenin 49(5) të Ligjit, autorizon Avokatin e Popullit të referojë aspekte për përputhshmërinë e rregullave/ligjit me Kushtetutën, ku përfshihet edhe Rregullorja. Kompetenca që i është dhënë Avokatit të Popullit për t'ia referuar DHSGJK-së nuk përfshin kërkesa referuese bazuar **vetëm** në një kërkesë nga një individ. Kjo do të ishte në kundërshtim të drejtpërdrejtë me nenin 113 të Kushtetutës dhe mund të interpretohet si tentim për të anashkaluar ligjin.
15. Çdo referim nga Avokati i Popullit drejtuar DHSGJK-së duhet të bazohet në vlerësimin e tij se ligji i kontestuar është i papajtueshëm me Kushtetutën. Gjatë shqyrtimit të kërkesës së mbrojtësve për referim DHSGJK-së, Avokati i Popullit analizoi elementet procedurale të një referimi të tillë. Me rëndësi thelbësore për këtë ishin dispozitat e rregullës 6(4) të RPDHSGJK-së, të cilat Avokati i Popullit i mori parasysh gjatë shqyrtimit.
16. Në lidhje me këtë, është me rëndësi të ceket se, Avokati i Popullit ishte në dijeni të Rregullores për Ndihmë Juridike të vitit 2024 që kur Administratorja e bëri të ditur, sepse kjo është pjesë e funksionit të tij për të monitoruar, mbrojtur dhe ruajtur të drejtat dhe liritë e personave që ndërveprojnë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
17. Gjatë shqyrtimit të kriterit për të siguruar ndihmë juridike të mjaftueshme, Avokati i Popullit u mbështet në vendimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen gjyqësore *Iglin v. Ukraine*, ku u konstatua:

“Përfaqësimi juridik i efektshëm përfshin të drejtën për kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur argumente mbrojtëse. Vlerësimi nëse koha dhe mundësitë janë të mjaftueshme, bëhet duke marrë parasysh rrethanat përkatëse të secilit rast konkret.⁶” (theximi i shtuar)

18. Mjaftueshmëria e Rregullores së vitit 2024 për të garantuar përfaqësim juridik të efektshëm, mund të matet vetëm rast pas rasti. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit

⁶ ECtHR, *Iglin v. Ukraine*, [GC], No. 39908/05, 12 January 2012, para.65.



thekson se Rregullorja për Ndhimë Juridike e vitit 2024 përcakton një mekanizëm për rishikim nga një panel kompetent të cilitdo vendim mbi ndihmë juridike.⁷

19. Nga një shikim i përgjithshëm, Avokati i Popullit thekson përsëri se parashtruesit e ankesës nuk pretenduan se ishte marrë ndonjë vendim konkret në përputhje me Rregulloren për Ndhimë Juridike të vitit 2024, ose se të drejtat e tyre u shkelën nga ndonjë vendim i tillë. Gjithashtu, katër parashtruesit janë në procedim para dhomave penale. Në radhë të parë, u takon dhomave penale të mbrojnë dhe të ruajnë të drejtat e të akuzuarve.⁸
20. Në rastin aktual, Avokati i Popullit vetëm mund të arrijë në përfundimin se i takon mbrojtësit të shfrytëzojë kornizën ligjore dhe procedurat e zbatueshme që përcaktohen në Rregulloren për Ndhimë Juridike të vitit 2024. Pjesë përbërëse e Rregullores është e drejta e të akuzuarit për mjet juridik të efektshëm.
21. Bazuar në arsyet e lartpërmendura, Avokati i Popullit hedh poshtë pretendimin se ai nuk mori parasysh kompetencën që i është dhënë DHSGJK-së për zgjatje të afatit sipas rregullës 26(2) të RRPDHSGJK-së. Gjithashtu, Avokati i Popullit hedh poshtë çfarëdo pretendimi se gaboi kur nuk e gjykoji të vlefshme, kërkesën për referim të Rregullores për Ndhimë Juridike të vitit 2024.
22. Së fundi, në lidhje me pikën e ngritur nga mbrojtësit për vizitën e Avokatit të Popullit në objektin e paraburgimit më 7 mars 2024, Avokati i Popullit nuk vizitoi objektin e paraburgimit më atë datë. Në fakt, ishte këshilltari ligjor i tij i cili vizitoi objektin e paraburgimit në emër të tij dhe i cili u takua me z. Januzi, i cili erdhi menjëherë pas konsultimit me mbrojtësin e vet.
23. Z. Januzi tha se mbrojtësi e kishte udhëzuar të ngrinte aspektin e uljes së ndihmës juridike për persona të akuzuar për vepra penale të administrimit para Dhomave të Specializuara dhe ai tha se Administratorja dhe Ministria e Drejtësisë e Kosovës po bashkëpunonin për të ulur pagesën për mbrojtës përmes skemës së ndihmës juridike, sepse dhe Qeveria e Kosovës kishte ndryshuar Rregulloren e vet për t'i ulur pagesat për mbrojtës për kategori të caktuara të veprave penale.
24. Kjo nuk ishte as ankesë formale e as joformale, por ishte thjesht një koment i të paraburgosurit. Avokati i Popullit u vu në dijeni lidhur me këtë aspekt, dhe tha të

⁷ Shih rregullën 10 të Rregullores për Ndhimë Juridike të vitit 2024.

⁸ Shih Vendimin e Avokatit të Popullit OMB-C-2024-02, para. 27, dhe KSC-CC-2024-23(1) Sabit Januzi, (2) Ismet Bahtijari dhe (3) Haxhi Shala kundër Zyrës Administrative të Dhomave të Specializuara të Kosovës, para 20.



njëjtën gjë. Çdo sugjerim se z. Januzi shprehu shqetësime konkrete se rregullorja e rishikuar ishte e papajtueshme me Kushtetutën dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe se kjo përbënte ankesë, nuk do të ishte pasqyrim i bisedës së zhvilluar.

25. Sido që të jetë, komenti i lartpërmendur nga i paraburgosuri nuk shton ndonjë element të rëndësishëm për aspektin në fjalë dhe nuk ndryshon përfundimet e shtjelluara më lart.

V. PËRFUNDIM

26. Avokati i Popullit hedh poshtë pretendimin se ai nuk mori parasysh kompetencën që i është dhënë DHSGJK-së për të zgjatur afatin e rregullës 26(2) të RPDHSGJK-së.
27. Avokati i Popullit hedh poshtë pretendimin se ai gaboi që nuk e gjykoi të vlefshme kërkesën referuese për Rregulloren për Ndihmë Juridike të vitit 2024.
28. Avokati i Popullit hedh poshtë kërkesën për rishikim të vlerësimit të parë të tij në lidhje me kërkesën për t'i referuar DHSGJK-së aspektin e përputhshmërisë së KSC-BD-25/Rev1, veçanërisht duke pasur parasysh rregullës 6(4) të RPDHSGJK-së dhe dispozitat që Avokati i Popullit të kërkojë zgjatje të afatit për t'ia referuar aspektin DHSGJK-së.

PIETRO SPERA

Avokati i Popullit, Dhomat e Specializuara të Kosovës

21 maj 2024

Në Hagë, Holandë